

KUSHTE TE VECANTA DHE SPECIFIKIME TEKNIKE KUADER

" SHERBIMI PER MIREMBAJTJEN E ASETVE ELEKTROENERGJITIKE PER TRE (3) VITE,"

I. KUSHTET PARAPRAKE PER TU ZBATUAR NE OFERTIM

1. Operatori Ekonomik duhet te jete i pajisur me :

- a. Shoqeria duhet te paraqesë Certifikaten e cilesise se punimeve **ISO 9001- 2015 ose e përditësuar** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).
- b. Shoqeria duhet te paraqesë Certificate **ISO 45001-2018 ose e përditësuar** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).
- c. Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 14001-2015 ose e përditësuar** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).
- d. Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 50001-2018 ose e përditësuar** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

➤ **Certifikatat duhet te jene ne gjuhen e ofertes (çertifikatat ne gjuhe te huaj duhet te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen), dhe ne perputhje me natyren e objektit qe tenderohen.**

II. KAPACITETET TEKNIKE DHE PROFESIONALE

1. Licensa Profesionale lidhur me ekzekutimin e puneve te Kontratave

1.1. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi". Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të

parashikuara ne sa me siper. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

N.P.11 – C Ndërtime për nënstacione, gabinet e transformacionit linjat e Tensionit te Larte T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

N.S.5 - A Ndërtime për Impjante te sinjalistikes ndricuese te trafikut.

N.S.12- A Impiante teknologjike ,termike dhe te kondicionimit.

N.S.14-A Impiante të brendëshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

1.2. Ne plotesim te kësaj kërkese, Ofertuesi duhet të paraqese;

1. Kopje te noterizuar te Certifikates se licensimit,
2. Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008).
3. Ne rast te bashkimit te operatore ekonomike, Licensat profesionale duhet ti paraqese operatori ekonomik qe ka marre persiper punimet per te cilat kerkohet Licensa Profesionale.

III. AUTORIZIME DHE ÇERTIFIKATA KUALIFIKIMI

- Ofertuesi duhet te paraqese,dokumente qe verteton se eshte i paisur me: Autorizime.., Certifikata Kualifikimi, Asisten –Suporte, leshuara Kompanise se Tij, si dhe ato leshuara drejtuesve teknik dhe personelit kyc, ku perfshihen:

Nisur nga specifikat e pajisjeve elektrike dhe elektroenergjitike, qe jane objekt i kesaj procedure prokurimi, kerkohet qe Operatori Ekonomik te zoteroje njohurite e pershtateshme dhe pervojen e duhur per te kryer sherbimin e mirembajtjes dhe riparimit te tyre te nevojshme keto per nje zbatim me sukses te kontrates nga ana e Tij. Operatori ekonomik, duhet te kete ne zoterim dokumenta qe do te vertetonin se kualifikimet profesionale te tij jane te plota dhe cilesisht ne perputhje me llojet dhe specifikat e sistemeve elektrike dhe elektroenergjitike te instaluar ne APD dhe qe do te mirembahen e riparohen prej tij, per kete ai duhet te prezantoje dokumenta si ; licensa, autorizime/marreveshje partneriteti dhe certifikata specializimi te leshuara nga prodhuesit kryesore te sistemeve te instaluar, si:

1. Pajisjet e rrjeteve energjitike TM
2. Pajisjet e rrjeteve energjitike TU
3. Pajisjet dhe sistemet e trajtimit te ajrit te kondicionuar (Chiller,Kondicioner Spliter)
4. Panelet e kontrollit automatik
5. Paisje UPS

-Çertifikata/deshmi kualifikimi profesionale te personelit kyc, te cilat duhet te mbulojne minimalisht fushat specifike, si me poshte:

- a. Sisteme te mbrojtjes ne rrjetat TU dhe TM,
- b. Pajisje te mbrojtjes ne rrjetat TU dhe TM,
- c. Sisteme HVAC,
- d. Sitemit te komandimit dhe kontrollit automatke,
- e. Pajisje te ndricimi.

Ne plotesim te kesaj kerkese, Ofertuesi duhet te paraqese:

Dokumentet perkatese te shenuara, leshuara kompanise se tij, origjinale ose kopje te noterizuara.

Nga Plotesimi i kushteve te ketij seksioni, Autoriteti Kontraktor Sigurohet se ;

Kualifikimet e Pergjithshme.., ato Specifike.., te Ofertuesi, si dhe ato te "shtuara" nepermjet raporteve te qendrueshme me partneret, perputhen me Tipologjine e Sherbimeve te Kerkuara, Objekt i Ketij Prokurimi te shprehura ne TeR,

IV. BURIMET NJEREZORE DHE KUALIFIKIMET PROFESIONALE TE OPERATORIT

- 1.** Ofertuesi duhet te prezantoje dhe dorezoje Strukuren Organizative te Shoqerise se tij.
- 2.** Ofertuesi, duhet te disponoje burime njerezore te mjaftueshme dhe cilesisht te kualifikuara, ndaj kerkohet qe Numri i pergjithshem i te punesuarve i Ofertuesit gjate dy viteve te fundit te ushtrimit v.2021 - v. 2022 deri ne momentin e hapjes se procedures , te jete me nje mesatare vjetore jo me pak se **30 (tridhjete)** punonjes ne muaj, ne plotesim te kesaj, kerkohet ;
 - 2.1. Nje vertetim leshuar nga dega rajonale e tatimeve ose sigurimeve shoqerore e shendetesore, mbi numrin e punonjesve te siguruar nga operatori per cdo muaj per periudhen e siperpermendur,
 - 2.2. Listepagesa e kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore si dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi (e-sig/25) te depozituara prane drejtorise se sigurimeve shoqerore per periudhen e siperpermendur dhe te certifikuara prej tyre.
- 3. Punonjesit e Kualifikuar ne kompani.**

Perberja e punonjesve te kualifikuar ne kompani, ne profesionet Inxhinjer dhe Teknike per, Zbatimi dhe Mirembajtje te kete ne pjesë të stafit të punësuar dhe të figurojë në listëpagesa per te pakten 6 (gjashtë) muajt e fundi, duhet te plotesoje kriteret ne vijim ;

 - 3.1. **2 (dy) Inxhinier**, me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e **Inxhinierit Elektrike** për drejtimin e të gjitha llojeve të shërbimeve "Zbatues i sistemeve industriale te furnizimit TM_TU", me eksperience jo më pak se 5 (pese) vjet në fushën e shënuar. Në plotësim të ketij kriteri, Operatori duhet të paraqese per secilin punonjes dokumentacionin si me poshte:
 - a. Kontrate dhe CV e inxhinjerit,
 - b. Kopje te diplomes se inxhinjerit.
 - c. Kopje e librezes se punes.
 - 3.2. **1 (nje) Inxhinier**, me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e **Inxhinierit Mekanik**, për drejtimin e të gjitha llojeve të shërbimeve "Zbatues i sistemeve te trajtimit te Ajrit te Kondicionuar "me eksperience jo më pak se 5 (pese) vjet në fushën e shënuar. Në plotësim të ketij kriteri, Operatori duhet të paraqese dokumentacionin si me poshte:
 - a. Kontrate dhe CV e inxhinjerit,
 - b. Kopje te diplomes se inxhinjerit.
 - c. Kopje e librezes se punes
 - 3.3. **1(një) Inxhinier**, me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e **Inxhinierit Elektronike** ,Automatike –Industri , për drejtimin e të gjitha llojeve të shërbimeve " Zbatues i sistemeve te komandimit dhe kontrollit automatik "me eksperience jo më pak se 5 (pese) vjet në fushën e shënuar. Në plotësim të ketij kriteri, Operatori duhet të paraqese dokumentacionin si me poshte:

- a. Kontrate dhe CV e inxhinjerit,
- b. Kopje te diplomes se inxhinjerit
- c. Kopje e librezes se punes.

3.4. **1(një) Inxhinier, i pajisur me Certifikate Auditues Energjie ne Ndertesa dhe ne Transport,** me eksperience jo më pak se 3 (tre) vjet në fushën e shënuar. Në plotësim të ketij kriteri, Operatori duhet të paraqese dokumentacionin si me poshte:

- a. Kontrate dhe CV e inxhinjerit,
- b. Kopje te diplomes se inxhinjerit.
- c. Kopje e librezes se punes.

3.5. **1(një) Inxhinier, i pajisur me Certifikate per sistemet BMS (Building management system) ,** me eksperience jo më pak se 3 (tre) vjet në fushën e shënuar. Në plotësim të ketij kriteri, Operatori duhet të paraqese dokumentacionin si me poshte:

- a. Kontrate dhe CV e inxhinjerit,
- b. Kopje te diplomes se inxhinjerit.
- c. Kopje e librezes se punes.

3.6. Te kete te punesur **12 (dymbedhjete) punonjes elektriciste** te certifikuar per nderhyrje te **Grupit te II-V** te Sigurise, te pakten **4(kater) prej tyre te pajisur me grupe sigurie IV-V me arsimin perkates,** percaktuar sipas Dëshmise se kualifikimit te sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve. Në plotësim të ketij kriteri, Operatori duhet të paraqese per secilin punonjes dokumentacionin si me poshte:

- a. Kontrate pune,
- b. Kopje te librezes se punes,
- c. Dëshmi profesionale të punonjësve (Certifikate/Diplome),
- d. Dëshmi e grupit te Sigurise te leshuar atij sipas percaktimeve me lart.

3.7 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar punonjës të kualifikuar për realizimin e zërave të punimeve/shërbimeve objekt kontrate, të pajisur me dëshmi kualifikimi, minimalisht si më poshtë:

2 (dy) Punonjes Hidraulik per sistemin Chiller, me arsimin perkates te certifikuar, me Dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve. Në plotësim të ketij kriteri, Operatori duhet të paraqese per secilin punonjes dokumentacionin si me poshte:

- b. Kontrate pune,
- c. Kopje te librezes se punes,
- d. Dëshmi profesionale të punonjësve (Certifikate/Diplome),
- e. Dëshmi e grupit III te Sigurise leshuar atij.

3.8. Te pakten **2(dy) punonjes elektricist** te certifikuar per nderhyrje **punime që do të kryhen në Lartësi,** me arsimin perkates te certifikuar, me Dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve. Në plotësim të ketij kriteri, Operatori duhet të paraqese per secilin punonjes dokumentacionin si me poshte:

- a. Kontrate pune,
- b. Kopje te librezes se punes,
- c. Dëshmi profesionale të punonjësve (Certifikate/Diplome),
- d. Dëshmi e grupit III te Sigurise leshuar atij.

3.14. Certifikatat e Grupit te Sigurise te prezantuara, duhet te jene kopje te vertetuara me origjinalin.

3.15. Ofertuesit e huaj, duhet te beje njesimin certifikatave te punonjesve per nderhyrje sipas grupeve te shenuara me siper, prane ISHTI _ Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

3.16. Ofertuesit duhet te plotesojne kerkesat e mesiperme per periudhen te pakten 6 (gjashtë) muajt e fundi duke vertetuar nepermjet listpagesave ((e-sig/25) te depozituara prane drejtorise se sigurimeve shoqerore per periudhen, dhe te certifikuara prej tyre) qe ka pasur dhe ka ne marredhenie pune punonjes te kualifikuar sipas struktures se kerkuar ne pikat 3.1.-3.8., me siper, pavaresisht emrave te tyre.

3.17. Mbeshtetur ne natyren e punimeve dhe sherbimeve te parashikuara duhet qe operatori ekonomik te kete ne stafin e tij të punësuar nje Inxhinier – Auditues Energjie të rezultojnë në listpagesat e shqërisë.

Për të vertetuar plotësimin e këtij kriteri, Operoret Ekonomike duhet të paraqesin:

- a. Inxhinier – Auditues energjie (1 person) (i pajisur me “Certifikate per auditimin e energjise)
- b. Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar ne mirmbajtje),
- c. Certifikata (Dip) per eficensen e energjise

3.18. Operatori Ekonomik duhet te kete te punesuar mjekun e shoqerise te pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, sipas parashikimeve te Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”,

- a. Kontratë pune të vlefshme,
- b. Urdhër mjeku, diplomë, Licenca e ushtrimit te profesionit,
- c. Librezë pune.
- d. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm

3.19. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të punësuar **1 (një) Ekspert Zjarrfikës**, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Certifikate per Ekspert Zjarrfikës.

(ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetare i grupit duhet te dorezoj kete dokument)

- a. Kontratë pune të vlefshme,
- b. Certifikate per Ekspert Zjarrfikës ,
- c. Librezë pune.

3.20. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të punësuar **1 (nje) punonjës që disponon certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë”**, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Në plotësim të këtij kriteri, Operatori duhet të paraqese dokumentacionin si me poshte:

- d. Kontratë pune të vlefshme,

- e. diplomën/certifikatën përkatëse. ,
- f. Librezë pune.

3.21 Operatori Ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me Licens per Leje Mjedisore Tipi III.2.B Menaxhimi i mbetjeve grumbullim dhe transport.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”

(ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetare i grupit duhet te dorezoj kete dokument)

V. KONTRATA TE NGJASHME

1. Ofertuesi duhet te kete realizuar kontrata te ngjashme për, Shërbime mirembajtje te infrastruktures energjitike dhe elektrike, Sistemeve te Trajtimit te Ajrit te Kondicionuar, Paisje komandim dhe kontrolli Automatike, UPS, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate, pa përfshirë vlerën e tvsh, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës . Për plotësimin e kësaj kërkesë Ofertuesi duhet të dorëzojë;

Këto shërbime të ngjashme do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori Ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate dhe me faturën tatimore përkatëse.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim:

Pune te ngjashme do te konsiderohen, shërbime, mirembajtje apo vendosje te pajisjeve objekt prokurimi.

Ne rastin e kontratave furnizim-vendosje, pune e ngjashme, do te konsiderohet Vlera e shërbimit, mirembajtjes apo vendosjes se pajisjeve objekt i ketij prokurimi.

VI. KAPACITETET FINANCIARE

1. Ofertuesit duhet te kene realizuar nje xhiro mesatare per 3 (tre) vitet e fundit te ushtrimit, 2019, 2020, 2021, jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontrates qe prokurohet. (jo me e vogel se vlera e fondit limit), pa përfshirë vlerën e tvsh., Për plotësimin e kësaj ofertuesi duhet të dorëzojë ;

1.1. Kopje te bilancit fianciar te ushtrimit te 3(tre) viteve te fundit v. 2019, v. 2020 dhe 2021, te certifikuara nga Administrata Tatimore.

1.2. Vërtetim për xhiron e realizuar për vitet 2019, 2020 dhe 2021 lëshuar nga Administrata Tatimore.

Sqarim: Nga Plotesimi i kushteve te ketij seksioni, Autoriteti Kontraktor Sigurohet se ;

- 1.3. Ofertuesi, gjindet ne situatë të mirë ekonomike,financiare dhe në përgjithësi të veprimtarisë së tij, se disponon asetë cilësorë të përshatësme dhe njëkohësisht të mjaftueshme për realizimin e kontratës, për këtë;
- 1.4. Autoriteti Kontraktor, nëpërmjet bilancëve të dorëzuara, do të analizojë kapacitetet e operatorit si dhe do të formojë një gjykim të përgjithshëm lidhur me qëndrueshmërinë e veprimtarisë së tij, nëpërmjet;

Raportet e strukturës lidhur me aktivin, Raportet e strukturës lidhur me pasivin, Treguesit lidhur me qëndrueshmërinë e financimit, .Treguesit lidhur me autonominë financiare, Raportet e sintezës ose të ekuilibrit financiar, . Rezultati, humbje- fitim,

VII. OFERTA TEKNIKE

Ofertuesit, në përputhje me kërkesat e shprehura në TeR dhe në dokumentat e tjera të këtij tenderi, duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtem:

1. Planin operacional të detajuar për zbatimin e kësaj Kontrate duke përfshirë metodologjinë, burimet njerezore, makineritë dhe pajisjet dhe sistemin koordinimit dhe menaxhimin.
2. Planet paraprake të mirëmbajtjes së asetëve dhe instalimeve energjitike; SHTOJCA_J - LISTA E SISTEMEVE DHE PAJISJEVE, për të cilët ofertuesit duhet të paraqesë programin e mirëmbajtjes sipas TeR.
3. Strukturën organizative për zbatimin e kësaj kontrate, me pozicionet përkatëse, në të cilin të jenë deklaruar dhe të përfshirë të paktën katër personat kyç punonjës të operatorit, të prezantuar nga ofertuesi në seksionin [III Burimet Njerezore dhe Kualifikimet Profesionale të Tyre](#) pika 3.
4. Planin e detajuar të investimit për 3 vitet e zbatimit të kontratës
5. Disponueshmërisë së mjeteve, Makineri, Pajisje, set vegla pune sipas listës të shënuara nga Autoriteti Kontraktor, Shtojca G, bashkangjitur, të cilën ofertuesi duhet ta plotësojë me sasitë modeli.

VIII. PLOTESIMI I SHTOJCAVE

1. Operatori duhet të bëjë plotësimet në shtojcat në vijim të parashikuara në Termat e Referencës_TeR
 - 1.1 SHTOJCA_D;PËRSHKRIM I AMBJENTEVE TË PUNES, OFIÇINA, MAGAZINA, ZYRA,TE KERKUARA NGA OPERATORI.

Me qëllim që Autoriteti Kontraktor të njihet me parë me kërkesat specifike të operatorit për ambiente pune dhe marjen e masave për plotësimin e mundshëm të tyre.
 - 1.2 SHTOJCA_F; LISTA E PERSONELIT KYC

Plotesimi i shtojces F, ka per qellim te njohe autoritetin kontraktor me listen emrore te personelit kyc te operatorit qe do te jene pjese e struktures se zbatimit praktik te veprimtarise te mirembajtjes ne APD.

1.3 SHTOJCA G:LISTA E MJETE PAJISJE , INSTRUMENTA ,APARATURA ,VEGLA TË MIRËMBAJTJES DHE RIPARIMIT.

- a. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.
- b. Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010:
- c. Operatori te paraqese nje deklarate sipas shtojces. Mjetet dhe deklarata mesiperme jane objekt verifikimi dhe kontrolli ne cdo kohe, ne vendodhjen e deklaruar nga operatori ekonomik ne dokumentat e tenderit, deri ne realizimin e plote te kontrates.
- g. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për paisjet teknike të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe te verifikushme modeli me te dhenat e tyre.
- h. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- i. Operatori ekonomik duhet të paraqesë nje deklarate ku paisjet mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues.

1.4 SHTOJCA H: PAJISJE APARATURA OPERACIONALE OPERATORI

- a. Dëshmi për pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.
- b. Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010:
- c. Operatori te paraqese nje deklarate sipas shtojces. Mjetet dhe deklarata mesiperme jane objekt verifikimi dhe kontrolli ne cdo kohe, ne vendodhjen e deklaruar nga operatori ekonomik ne dokumentat e tenderit, deri ne realizimin e plote te kontrates
- g. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për paisjet teknike të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe te verifikushme modeli me te dhenat e tyre.
- h. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- i. Operatori ekonomik duhet të paraqesë nje deklarate ku paisjet mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues.

- e. Per pajisjet teknike sipas tabelës nr 5, operatori ekonomik, duhet të paraqesë kontratat e shitblerjes / faturat tatimore të shitjes si dhe skemat teknike të pajisjes, ndërsa kur pajisjet janë të mara me qera duhet të paraqitet kontrata e qerës, fatura tatimore e shitjes / kontrata e shitblerjes si dhe skema teknike e pajisjes.

1.5 SHTOJCA I; MJETE NGRITËSE DHE TRANSPORTUESE OPERATORI

- a. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.
- b. Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010:
- c. Operatori të paraqesë një deklaratë sipas shtojcës. Mjetet dhe deklaratat mesipërme janë objekt verifikimi dhe kontrolli në çdo kohë, në vendodhjen e deklaruar nga operatori ekonomik në dokumentat e tenderit, deri në realizimin e plotë të kontratës. Makineri- pajisjet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuara.
- d. Per mjetet sipas tabelës nr 6, operatori ekonomik, duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jete e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi (nese është i treguar); c) çertifikatë e kontrollit teknik (nese është i treguar); d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vëndit (nese është i treguar)(e vlefshme). "
- e. Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerës e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi (nese është i treguar); ç) çertifikatën e kontrollit teknik (nese është i treguar), d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vëndit (nese është i treguar)(e vlefshme).
- f. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- g. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për pajisjet teknike të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe të verifikueshme modeli me të dhenat e tyre.
- h. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- i. Makineritë dhe pajisjet mesipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues.

1.4 SHTOJCA J; LISTA E ASETËVE "IEN", PËR TË CILET OFERTUESIT DUHET TË PARAQESË PROGRAMIN E MIREMBAJTJES.

1.5 SHTOJCA 2, OFERTA EKONOMIKE.

Per shkak te specifikes se sherbimit, objekt i ketij prokurimi, Autoriteti Kontraktor ka vendosur ne DT, dokumentin “OFERTA EKONOMIKE” e cila do plotesuar nga operatori ne cilesine e “Formularit te Cmimit te Ofertes” dhe pjese e tij.

Per plotesimet e mesiperme ofertuesi duhet te perdore:

- i) Tabellen e pergatitur nga APD te bashkengjitur me titullin: “Shtojcat_17_Projekti_EN”

KOMISIONI I PERCAKTIMIT TE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PERLLOGARITJES SE VLERES SE KONTRATES